



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS

Nr. 3224 Prot.

Tirane, më 07.11. 2024

**URDHËR I PËRBASHKËT**

Nr. 12 datë 07.11. 2024

“**MBI**

**PAGESËN E TARIFAVE TË SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E PARË, TË DYTË DHE TË TRETË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2024-2025 NË UNIVERSITETIN E SPORTEVE TË TIRANËS”**

Në zbatim të Vendim Senati Nr. 49 datë 18.07.2024 Për miratimin e propozimit të propozimit të tarifave të regjistrimit për konkurs, regjistrimit të fituesve, për ciklin e parë, të dytë, të tretë të studimeve dhe tarifave të shkollimit për të tre ciklet e studimeve në Universitetin e Sporteve të Tiranës për vitin akademik 2024-2025”, Vendimit të BA nr. 32 datë 07.08.2024 “Për miratimin e tarifave të regjistrimit për konkurs, regjistrimit të fituesve, për ciklin e parë dhe të dytë, të tretë të studimeve dhe tarifave të shkollimit për të 3 ciklet e studimeve në UST” Rektori dhe Administratori,

**URDHËROJNË:**

1. Të kryhen veprimet për pagesën e tarifës së shkollimit nga studentët e Ciklit të Parë, Ciklit të Dytë dhe të Tretë të studimeve, sipas programeve të studimit në të tre fakultetet.
2. Për ciklin e parë të studimeve afati i derdhjes së tarifës së shkollimit është 31.01.2025.
3. Afati i derdhjes së tarifës së shkollimit për ciklin e dytë të studimeve është i ndarë në dy kështe;
  - Kësti i parë është deri në datën 31.01.2025.
  - Kësti i dytë është deri në datën 15.04.2025.
4. Për ciklin e tretë të studimeve afati i derdhjes së tarifës së shkollimit është i ndarë në dy kështe ;
  - Kësti i parë është deri në datën 31.01.2025.
  - Kësti i dytë është deri në datën 15.04.2025.

5. Për studentët me mesatare mbi 6 që ju është reduktuar tarifa e shkollimit 50%, dhe studentët me mesatare 9-10 përjashtuar nga tarifa e shkollimit, të kryhen veprimet përkatëse në sistem për të reflektuar reduktimin e tarifës së shkollimit.
6. Studentët që kanë dorëzuar dokumentacionin për përjashtim nga tarifa e shkollimit nuk do të derdhen tarifën e shkollimit deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga Bordi i Administrimit.
7. Komisioni i shqyrtimit të dokumentacionit për aplikim për bursë dhe përjashtim nga tarifa e shkollimit i ngritur me Urdhër të përbashkët nr. datë 23.10.2024, të dorëzojë materialin përkatës për vlerësimin e dokumentacionit të dorëzuar nga studentët e ciklit të parë dhe të dytë brenda 06.03.2025, pasi materiali do të paraqitet për miratim pranë Bordit të Administrimit.
8. Ngarkohen Njësitë Kryesore dhe Drejtoria e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, dhe mënyrë elektronike pranë Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit sipas modelit të përcaktuar, të dhënat për studentët sipas programeve të studimit brenda datës 10.12.2024.
9. Ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit në bashkëpunim me Drejtorinë e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore, në përfundim të afateve të përcaktuara më lart, të dërgojmë pranë Rektorit dhe Administratorit informacionin përkatës mbi ecurinë e procesit dhe evidentimin e studentëve debitor.
10. Në përfundim të vitit akademik 2024-2025 Drejtoria e Financës dhe Buxhetit pas reakordimit me Drejtorinë e Zhvillimit të Programeve dhe Digjitalizimit të Shërbimeve Akademiko-Shkencore të përcjellë zyrtarisht regjistrin e derdhjes së tarifave të shkollimit.
11. Për mos zbatimin e këtij Urdhëri të Përbashkët ngarkohen me përgjegjësi strukturat përkatëse.
12. Ky Urdhër i Përbashkët hyn në fuqi menjëherë.

**ADMINISTRATOR**

**Haxhirete SULAJ**



**REKTOR**

**Prof. Dr. Agron KASA**

